



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRAN	
01 Nr. / Br	16/25
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	30.01.2025
VUSHTRRI - VUÇITRAN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" në lidhje me nenin 69 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 në lidhje me nenin 68 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **30 janar 2025** merr këtë:

**VENDIM
PËR APROVIMIN E PETICIONIT**

1. Me këtë vendim aprovohet peticioni i banorëve të fshatit Reznik, lagjet Kasumi, Mustafa dhe Sylja, të parashtruar në emër të z. Xhafer Kasumi, që lidhet me kërkesën e këtyre banorëve për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës me Nr.868 në fshatin Reznik.
2. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë obligon Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë t'i caktojë pikat kah është rruga publike, ndërsa obligohet Drejtoria për Shërbime Publike si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ta mirëmbajnë këtë vit me zhavor, këtë rrugë, kurse vitin e ardhshëm të parashihet asfaltimi i kësaj rruge.
3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Shërbime Publike që ta informoi Kuvendin e Komunës dhe parashtruesit e peticionit për veprimet e ndërmarrura lidhur me këtë çështje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRIN

01 Nr. / Br 17/25

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 30.01.2025

VUSHTRRI - VUÇITRIN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës – Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridike – OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim me numër të protokollit Nr. 49/23 datë 23.02.2023, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **30 janar 2025** merr këtë:

V E N D I M
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR ADEM HASANIN

1. Me këtë vendim z. Adem Hasani, nga fshati Ropicë i ndahen mjete financiare në shumë prej tremijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë euro (3,760.00 €), ndihmë financiare për shërim.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, Zyra e Kryetarit të Komunës, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 16024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 19/25

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 30. 01. 2025

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marrë për bazë kërkesë për rishqyrtimi e aktit komunal, me numër të referencës Nr.020-743/4 e datës 19.12.2024 të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me vendimin Nr.216/21 i datës 02.12.2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **30 janar 2025** merr këtë:

VENDIM


për shfuqizimin e vendimit me nr.216/21 i datës 02.12.2024

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 216/24 i datës 02.12.2024, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh** bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, Nenet 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, nenit 6 paragrafit 1.2, nenit 14, nenit 21 paragrafit 1.3 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 24 paragrafit 5 dhe nenit 25 paragrafit 6 të Rregullores QRK NR.09/2020 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 16 pika 16.6.4 të Rregullores (KKV) NR.09/2023 Rregullore për Tarifa , Ngarkesa dhe Gjoha Komunale 01Nr.286/23 të dt.28.12.2023 , vlerësimit dhe shqyrtimit nga MAPL të Vendimit Nr.196/24 të datës 31.10.2024 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës dhe nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **30 janar 2025**, merr këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TE PRONËS SË PALUJTSHME KOMUNALE NDËRTIMORE TE KOMUNËS SË VUSHTRRISË

1. Me këtë vendim lejohet dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202021-000519-0, Zona Kadastrale Stanofc i Epërm e cila përfshinë një sipërfaqe prej 14.84m² të marr nga sipërfaqja e përgjithshme 3132.3m² pronë e Komunës së Vushtrrisë dhe prona e paluajtshme e Komunës së Vushtrrisë e cila gjendet në ngastrën kadastrale me nr.P-70202021-00575-0, Zona Kadastrale Stanofc i Epërm e cila përfshinë sipërfaqe prej 16.85m² të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10053m², në shumën prej 200 euro/copë.
2. Ngastrat kadastrale të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite KEDS-it, për vendosjen e trafostacionit shpërndarës (blind) në sipërfaqe prej 4.00 X 3.00 m² dhe 4.00 X 4.00m².
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Pjese përbërëse e këtij vendimi janë: certifikatat e pronësisë, kopja e planit, skicat e projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRIN

01 Nr. / Br 21/25

Nr. i fq. / Br. st - 2 -

Data: / Datum 30.01.2025

VUSHTRRI - VUÇITRIN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d”, nenin 14 dhe 17 shkronja “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 datë 04 qershor 2008), si dhe nenin 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave për periudhën 2022-2026, si dhe duke marrë për bazë kërkesën e NPL “Përparimi” në Vushtri, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **30 janar 2025** merr këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË MENAXHIM TË QENDRËS PËR GRUMBULLIM RICIKLIM DHE PAKETIM TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË FSHATIN BUKOSH

1. Me këtë vendim, NPL “Përparimi” SH.A në Vushtrri i ipet në menaxhim në kohë të pacaktuar Qendra për grumbullim riciklim dhe paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh, Komuna Vushtrri, pronë e paluajtshme e Komunës e regjistruar si vijon:

- 1.1 Pjesa e ngastrës kadastrale nr. 70202010-0, në sipërfaqe prej 10000 m², Zona Kadastrale Bukosh,
- 1.2 Objekti në sipërfaqe prej 410 m² i ndërtuar në ngastrën e cekur në nënparagrafin paraprak,
- 1.3 Pajisjet: një makinë transportuese shpërndarëse (pikap kamionetë), një kamion për grumbullimin e mbeturinave, një shirit transportues, dy peshore matëse, një vinç i motorizuar, një vinç manual, katër makina balluese si dhe 100 (njëqind) kontejnerë të shpërndarë në terren për riciklim të mbeturinave.

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të kësaj Qendre është funksionalizimi i saj përkatësisht fillimi i ushtrimit të aktiviteteve nga NPL “Përparimi” SH.A për grumbullimin riciklimin dhe paketimin e mbetjeve të riciklueshme duke qenë se kjo qendër dhe pajisjet e kësaj qendre nuk janë shfrytëzuar me vite të tëra për shkak të mungesës së stafit menaxhues – punues, e gjithë kjo në funksion të ekonomisë qarkore.

3. Obligohet Kryetari i komunës që pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi të lidhë marrëveshje me Kryeshefin Ekzekutiv të NPL “Përparimi” në Vushtrri me të cilën do të përcaktohen detajet e dhënies në menaxhim të Qendrës për grumbullim, riciklim dhe paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Shërbime Publike.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Melihate Basholli-Latifi





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 22 / 25

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 30. 01. 2025

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 në lidhje me nenin 37 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **30 janar 2025**, merr këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT LIDHUR ME THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.04/22 i datës 14.01.2022 lidhur me themelimin e Komiteti për Politikë dhe Financa ashtu që në vend të z. Alban Bajrami nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) emërohet z. Adnan Lahu, nga i njëjti subjekt politik.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

